

Dr. Mustafa Ceriq (Cerić)\*

## KRITIKA E FETARISË SË KULLUAR<sup>(1)</sup>

*Si mund të besoj?  
Si mund të veproj?  
Si mund të shpëtoj?*

### Dilemë rreth kuptimit të fetarisë

Mos e drejto vëmendjen nga dilema ime! Edhe unë dikur kam menduar se e kuptoj fetarinë, por tani jam në mëdyshje. Nuk jam i sigurt nëse sot kemi përgjigje të saktë për pyetjen që bëhet në lidhje me kuptimin e fjalës “fe”. Nuk duhet të ndalosh në këtë pyetje! Shko më tutje me bindjen se e kupton fetarinë! Ndërsa unë nuk mund të shkoj më tutje. Më duhet të qëndroj te çështja e kuptimit të fetarisë. Unë e ndiej se jam te fillesa. Nuk e kam të qartë se ç’është në thelb, edhe pse e kam kokën plot me tregime për këtë. Kam menduar se di çdo gjë, por tani po e kuptoj se nuk di asgjë. Prandaj kam vendosur që të nxis të kuptuarit rreth konceptit të fetarisë; kam vendosur që rishtas të lexoj dhe të mësoj; kam vendosur që të shmang dilemën. Edhe ti dëgjo, nëse dëshiron të dëgjojmë përsëri jehonën e shpellës Hira që përhapet nëpër kozmos (Lexo në emrin e Zotit tënd!). (Kuran, 96/1)

### Kjo analizë është kritika e fetarisë së kulluar

Trajtimi i pyetjes për kuptimin e fetarisë, nuk u drejtohet atyre që e kanë të gatshme përgjigjen, as atyre që dinë çdo gjë. Ky diskutim është destinuar për të zotët e mendjes, për poseduesit e dijes që e dinë se nuk dinë gjë dhe pyesin që të mësojnë atë që nuk e dinë. Kjo analizë është kritika e fetarisë së kulluar. Kurrsesi kritika e fetarisë së kulluar nuk është antifetare. Ajo është përpjekje shpirtërore dhe mendore që të matet forca e saj në realizimin

\* Mustafa Ceriq ka qenë myftiu i Bosnje Hercegovinës gjatë viteve 1993 – 2012.

<sup>1</sup> Përktheu nga boshnjakishta Ismail Dizdari

dhe shfaqjen e saj të shkëlqyer dhe imanente. Kritika e arsyes së kulluar buron nga pyetjet: çfarë mund të di? Çfarë mund të bëj? Për çfarë mund të shpresoj? Paralel me këtë, kritika e fetarisë së kulluar buron nga pyetjet: Si mund të besoj? Si të veproj? Si mund të shpëtoj? Në fakt kritika e fetarisë së kulluar është vazhde e gjurmës së paralajmërimit:

*“Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lejohen të thonë: “Ne besojmë”, pa u vënë në provë?! Ne i kemi provuar ata që kanë qenë para tyre, në mënyrë që Allahu të dallojë ata që thonë të vërtetën dhe ata që gënjejnë”.*

(Kuran, 29/1)

### **Fetaria nuk është vetëmatëse**

Shumë kohë para filozofit gjerman Emanuel Kant (1724-1804), filozofi mysliman El-Gazali (1058-1111) ka treguar se arsyeja njerëzore përpiqet që të ketë forcë vetëmatëse, e që mundet t'i përcaktojë për veten normat morale dhe të gjykojë vetveten. Për më tepër, El-Gazali ka paralajmëruar se arsyeja njerëzore mund të jetë peshore hyjnore mbi tokë (*Sultanul aklil-ledhi huve mizanullahi fil-erdi*). Ndërkohë, fetaria, besimi, nuk janë arsye. Fetaria është më tepër se arsyeja, dhe për këtë shkak arsyeja nuk mund ta masë, apo ta peshojë fetarinë deri në fund. Arsyeja është e ftuar që të masë, të peshojë gjërat, po kështu edhe fetarinë, por atë nuk mund ta masë deri në fund. Fetaria nuk mund të masë as vetveten. Fetaria e kulluar varet nga vlera e jashtëzakonshme e masës së vet. Pikërisht për këtë arsye, fetaria përfshin masën e gjykimit më të madh, i cili nuk është detyrimisht “këtu” dhe “tani”. Për këtë arsye, ju mos e gjykoni njëri-tjetrin për fetarinë këtu dhe tani.

*“Zoti do t'ju gjykojë juve për kundërshtitë që keni pasur ndërmjet jush”*

(Kuran, 22/69)

Pra, arsyeja nuk është më e madhe se fetaria. Fetaria është më e madhe se arsyeja (mendja), por mendja e kupton jo me dëshirë këtë. Ajo dëshiron të imponohet, të bëhet masë ekstreme për fetarinë, edhe pse ajo nuk mund të jetë e tillë, sepse forca e saj varet nga forca e fetarisë së kulluar. Mendja, arsyeja e ndjen më

mirë imponimin e fetarisë, kur të ndjejë fundin e vet mbi tokë. Për jetën pas vdekjes, fetaria është i vetmi shpëtim. Këtu qëndron ndryshimi ndërmjet mendjes, arsyes së kulluar dhe fetarisë së kulluar. Fetaria e kulluar është shpëtim për mendjen e kulluar, mendja e kulluar është sukses për fetarinë e kulluar. Sigurisht kjo duhet argumentuar.

### **Njeriu ka tri forca imanente**

Njeriu ka tri forca imanente me anën e të cilave manifestohet forca e jashtëzakonshme e fesë: forcën e zemrës, forcën e arsyes dhe forcën e dorës. Zemra posedon forcën njerëzore për të besuar; arsyeja ka forcën njerëzore për të menduar; dora ka forcën njerëzore për të vepruar. Bashkërisht këto tri forca njerëzore kanë një “forcë mbinjerëzore”, e kjo është besimi te Zoti. Mungesa e njëres nga këto tri forca në tërësinë e mentalitetit të ekzistencës fizike dhe shpirtërore të njeriut shtrun pyetjen për shpëtimin dhe suksesin e tij. Kritika e fetarisë së kulluar është shqyrtim dhe kërkesë për secilën nga këto tri forca veç e veç. Por, më e rëndësishmja nga ky shqyrtim është shqyrtimi i “forcës mbinjerëzore”, si manifest koordinator i forcës së jashtëzakonshme hyjnore dhe shpirtit imanent të njeriut.

### **Fetaria e pastër është “Frymë hyjnore”**

Shpirti njerëzor zë fill te rrënjët e frymës hyjnore. Sipas kësaj, shpirti njerëzor është pasqyrim i frymës hyjnore. *“Në formën e trupit njerëzor, Zoti fryu Shpirtin e (krijuar prej) Tij”*. (Kuran, 32/) Edhe nëse është krijuar nga fryma hyjnore, shpirti njerëzor nuk është i njëjtë me frymën hyjnore. Fruti i mollës del nga rrënjët e mollës, por nuk është i njëjlojtë me rrënjët e mollës. Ashtu siç nuk ka frut molle pa rrënjët e mollës, ashtu nuk ka as shpirt njerëzor pa rrënjët e shpirtit njerëzor, e kjo është fryma hyjnore. Fetaria e kulluar është “fryma hyjnore” e cila prek, takon “zemrën” e njeriut, “mendjen” njerëzore, dhe “dorën” njerëzore respektivisht. Nëse “fryma hyjnore” nuk i prek dhe ngacmon njëkohësisht edhe “zemrën, mendjen dhe dorën e njeriut”, atëherë kjo do të thotë që njeriu nuk është pjekur, nuk është rritur, që të mbajë porosinë, zotimin e “forcës mbinjerëzore” që manifestohet nëpërmjet fetarisë së kulluar te Zoti.

## Njeriu është i lirë të besojë ose jo

Njeriu është i detyruar të ruajë pastërtinë e frymës hyjnore te vetja e tij, ashtu si shpirtin, fenë, zemrën, mendjen dhe dorën e vet të pastër. Kjo, sepse pa zemër të pastër, nuk ka mendje të pastër, pa mendje të pastër nuk ka duar të pastra, kurse pa zemër të pastër, pa mendje të pastër dhe pa duar të pastra, nuk ka fe të kulluar. Nëse te njeriu nuk ka fe të pastër, nuk ka as besim të pastër ndaj Zotit. Pra, duhet të dallojmë besimin te njeriu nga besimi te Zoti. Besimi, fetaria te njeriu, nuk është njëlloj si besimi te Zoti. Forca e besimit te njeriu është vetëm forcë e besimit te Zoti. Kjo forcë e besimit te njeriu mund të mbetet e vdekur ndaj besimit te Zoti. Po kështu, forca e besimit te njeriu mund të bëhet vetëm e vdekur ndaj forcës së besimit ndaj njeriut. Zoti nuk varet nga besimi i njeriut. Zoti është i besueshëm (el-mu'min) (Kuran 59/23) te vetja dhe për vete. Njeriu mundet, por mund të mos jetë besimtar (mu'min) te vetja, për vete dhe për Zotin. Por, njeriu duhet të jetë i përlurur (muslim) ndaj ligjeve fizike pa marrë parasysh nëse ka apo jo besim tek ato. Oh, sa madhështore buçet kjo: O njeri, ti je i lirë të besosh ose jo!

*“Është Ai që ju krijoi, kurse disa prej jush nuk besojnë e disa besojnë...”*.

(Kuran, 64/2)

Por ti, o njeri, je i detyruar të dish se besimi yt ose mosbesimi yt, nuk ndikon te ligjet fizike, të cilave ti je i detyruar t'u përulesh me ose pa dëshirë. A nuk është kështu o njeri?!

## Tek shpirti ndodhen të gjitha përgjigjet

Po, ashtu është, o njeri! Por, karakteri im është i përzier me karakterin e armikut tim më të madh. Ai më nxit vazhdimisht që ta ndjek atë për rebelim ndaj ligjeve fizike. Ai më nxit që të ndryshoj jo vetëm ligjet fizike, por edhe ligjet metafizike. Më nxit që të përmbys gjithçka së prapthi. Edhe për mua, ashtu si për atë, ky rregull dhe renditje, ky ligj hyjnor, të cilin e njoh, e pranoj, është më i përkryeri nga të gjithë. Por, për mua kjo s'ka kuptim nëse nuk ekzistoj, nëse unë duhet të lë çdo gjë që kam në tokë, nëse unë duhet të shkoj nën tokë. Përse nuk jam i përjetshëm kur dëshiroj të jetoj? Përse jam një hiç, nëse dua që të jem dikush e diçka? Por, ndalo, o njeri! Përse je i padrejtë ndaj vetes? Përse nuk

e dëgjon shpirtin tënd? Përse nuk e pyet mendjen tënde? Përse nuk e hap dorën tënde? Te shpirti yt i ke të gjitha përgjigjet, me kushtin që të dish të lexosh shenjat, gjurmët fizike dhe metafizike. Nuk je i përjetshëm me trup, por je i përjetshëm me shpirt, nëse e di që shpirti yt vjen i pastër prej Krijuesit. Je i vdekshëm sipas ligjit fizik, por je i gjallë sipas ligjit metafizik, nëse e di që mendja jote e kulluar është pasqyrimi i shpirtit tënd të pastër, i cili vjen prej Krijuesit hyjnor. Ti je askush dhe asgjë në varësi të veprës së keqe të dorës sate të mbyllur, por je dikush dhe diçka në varësi të veprës së mirë të dorës sate të hapur.

### **Pyetje që kërkojnë përgjigje**

Mbaje mend! Forca e zemrës është forca e besimit, forca e mendjes është forca e arsyes dhe forca e dorës është forca e moralit. Në zemër fshihet forca e besimit të vërtetë ose e besimit të gënjeshtërt, tek mendja fshihet forca e diturisë ose e mosdijes, te dora fshihet forca e së drejtës ose e të padrejtës. Detyra e këtij diskutimi është që t'u përgjigjet këtyre pyetjeve: A janë besimi dhe fetaria diktat? A është diktati dogmë? A janë fetaria dhe besimi mendim dhe arsye, apo mendimi, arsyeja është fe? A janë fetaria dhe besimi dhuratë nga Zoti, apo besimi dhe fetaria janë përpjekje dhe tension i shpirtit njerëzor? A mund të ekzistojë fetaria pa mendimin, pa arsyen? A janë fetaria dhe mendimi njëlloj? A është mendimi ndaj fetarisë i pagabueshëm? Ç'është fetaria? A janë fetaria dhe besimi forca të bindjes apo forca të njohjes? A ekziston fetaria e kulluar? Nëse ekziston fetaria e kulluar, atëherë ç'është fetaria e pakulluar? Ku ndryshon fetaria e kulluar dhe feja e mësuar te Zoti?

### **Nëse provohet apo eksperimentohet që të konkurrohet me Zotin, njeriu është në humbje**

Nuk ka diktat më të fortë, as motiv më të fuqishëm nga diktati dhe motivi i fetarisë së kulluar. Nuhu (a.s) ka ndërtuar anijen sipas diktatit të fetarisë së kulluar; Ibrahim (a.s) ka qenë gati të flijojë të birin sipas diktatit të fetarisë së pastër; Musai (a.s) është përballur me Faraonin sipas diktatit të fetarisë së kulluar; Isai (a.s) ka duruar çdo gjë bazuar te fetaria e kulluar; Muhamedi (a.s) bazuar te diktati i fetarisë së kulluar ka lënë çdo gjë në Mekë që të shpëtojë

çdo gjë në Medinë. Ata që janë të detyruar të afirmojnë fetarinë e kulluar si diktat, nuk e kanë të vështirë ta mbrojnë këtë fakt. Ata që e kanë fenë në shpirt si një të vërtetë të padiskutueshme, e pranojnë diktatin e fetarisë së kulluar si punë të mbaruar, ku nuk ka dyshim e për të cilën nuk ka diskutim. Në të vërtetë, kuptimi i diktatit fetar është pranimi i ultimatimit hyjnor pa dialog, si shenjë e fesë, si mirësi. Zoti është i mirë dhe çdo gjë që porosit, urdhëron ai është mirësi në vetvete. Dobia mund të mos jetë menjëherë e qartë apo përfitim i menjëhershëm, por shpirti duhet të përulet që urdhrin, porosinë e Zotit, ta pranojë e ta zbatojë menjëherë.

Dobinë e urdhrin hyjnor njeriu mund ta mësojë më vonë ose asnjëherë, por duhet të besojë vazhdimisht se çdo urdhër i Zotit është i dobishëm dhe fitimprurës për të. Zoti e ka krijuar njeriun dhe ai e di më mirë se njeriu ç'është më e mira për të. Njeriu është i paditur. Për këtë arsye, vazhdimisht duhet ta nxitësh që të kuptojë se duhet të lexojë dhe të mësojë, në mënyrë që të njohë dhe të mësojë se ku e ka vendin në botë. Nëse provon që të konkurrojë me Zotin, njeriu është në humbje. Jo për faktin se Zoti nuk e lejon të njohë të vërtetën, por për arsye se, në momentin që ai e harron pozicionin e vet në raport me Zotin, me Krijuesin e tij, njeriu mendon se është i mjaftueshëm me vetveten, dhe i duket që Krijuesi e pengon në udhën e njohjes së çdo gjëje. Në të vërtetë, njeriu nuk është i aftë të njohë vetveten. Është e qartë se kur ai të njohë vetveten, mund të njohë Krijuesin e vet, dhe krahas kësaj mund të njohë edhe pozicionin e tij në botë: *"Ai që njeh vetveten, njeh edhe Krijuesin e vet.* Por, sipas karakterit të tij, njeriu dëshiron të flasë më tepër për atë që nuk duhet të dijë, e që nuk duhet t'i përkasë, sesa për atë që duhet të dijë e që duhet t'i përkasë. Në të vërtetë, njeriu duhet të dijë "kush është dhe çfarë është" dhe duhet t'i interesojë "përse është tani këtu".

### **Fetaria e kulluar ka mbetur në parajsë**

Pyetja se ku përfundon diktati i fetarisë së kulluar dhe ku fillon diktati i kulluar i njohjes njerëzore, shtron një nga çështjet nga më provokueset për mendjen njerëzore. Këtë pyetje e bëjnë ata që besojnë më tepër te diktati i arsyes së kulluar, sesa te diktati i fetarisë së kulluar. Ata që i japin përparësi diktatit të fetarisë së kulluar mbi diktatin e mendjes së kulluar, përgjigjen se kjo pyetje

është e gënjeshtërt. Për ata, në të vërtetë, pyetja e saktë është se ku përfundon diktati i mendjes së korruptuar dhe ku shpallet, shfaqet, diktati i fetarisë së kulluar. Kjo, sepse besimi (fetaria) i kulluar për të cilën bëhet fjalë këtu, nuk është korruptuar nga djalli. Për sa kohë Ademi (a.s) ishte në fetarinë e vërtetë, djalli nuk mundi ta mashtronte që të shijonte mollën e ndaluar; për sa kohë nuk ia turbulloi arsyen me logjikën e vet helmuese etj., me diktatin e mendjes së korruptuar, që ai të shkelë “diktatin e fetarisë së kulluar” se do të jetë i pavdekshëm. Kjo ka qenë vepra e parë e mendjes së korruptuar që është transmetuar nga parajsja në Tokë. Toka u bë kështu vendi për rënien, rrëzimin e ndërgjegjes së korruptuar ose të mallkuar, e cila nuk pushon së godituri mendjen njerëzore.

Fetaria e kulluar ka mbetur në parajsë. Atje na pret, te fundi ynë. Por, dua që të dihet se “religjioni” nuk është njësoj si fetaria e kulluar. Religjioni ose teologjia instruktive, është shpesh mutacion i ndryshimeve të shumta të substancave genetike nga fetaria e kulluar. Ky mutacion është i vazhdueshëm nëse ndodh në qendrën e korruptuar të mendjes njerëzore. Shkaqet janë të shumta, por njëri është më i efektshmi, e ky është zotimi i mallkuar që të bëhet çdo gjë, me qëllim që njeriu të harrojë diktatin e fetarisë së kulluar. Djalli ofron “religjionin” e vet, apo teologjinë e cila përmban elemente feje, por shpesh nuk ka pastërtinë e as qartësinë e fetarisë së pastër. “Teologjia” e djallit ka liri të përbaltë fetarinë e kulluar te njeriu. Djalli e di se femohimi i sigurtë është më i fuqishëm se fetaria e rremë, e cila manifestohet te teologjia e korruptuar religjioze.

### **Ndryshimi ndërmjet atyre që shpifin dhe nuk shpifin ndaj Zotit**

Ndryshimi ndërmjet atij që beson, por nuk shpif për Zotin dhe atij që beson dhe shpif ndaj Zotit, qëndron në faktin se ai që nuk shpif ndaj Zotit është i sigurt në vetvete dhe në besimin e tij te Zoti dhe për këtë arsye nuk ka nevojë t’ia argumentojë ndokujt këtë; ndërsa ai që beson dhe shpif ndaj Zotit, nuk është i sigurt në vetvete, as nuk është i sigurt te besimi i vet ndaj Zotit dhe për këtë arsye kërkon që ta argumentojë këtë te të tjerët, duke e ftuar Zotin për dëshmitar, por duke ruajtur të drejtën që hipokrizinë ose dyshimin e tij (*nifak*) ta mbajë për vete.

Në asnjë mënyrë thirrja e Zotit për dëshmitar në fe nuk është hipokrizi në vetvete, por as apriori e pastër nga kjo. Teologu mysliman El-Esh'ari (874-936), e konsideron kusht të vlefshëm të fetarisë së kulluar marrjen e Zotit për dëshmitar, ndërsa El-Maturidi (853-944) mendon se për vlefshmërinë e fetarisë së kulluar, njeriu duhet të marrë përsipër përgjegjësinë për atë që beson. Njeriu nuk mund të fshihet pas dëshirës së ndokujt. Ai duhet të jetë i sigurt dhe i sinqertë në deklarin e besimit të vet ndaj Zotit. Ai s'mund të ketë asnjë grimë dyshimi, as në mënyrën e deklarinimit të marrëveshjes: "në dashtë Zoti".

### **Kritika e fetarisë së kulluar është metodë e domosdoshme për pastrimin e ndërgjegjes fetare**

Ata që janë të detyruar të mohojnë fetarinë e kulluar, sidomos besimin e pastër ndaj Zotit, ua lehtësojnë punën atyre që përbaltin fetarinë e kulluar me interpretimin e tyre të gabuar dhe prezantimin e tyre të rremë. Nëse duhet kërkuar se ku Kurani i madhëruar është më i rreptë, atëherë kjo me siguri ndodhet te thirrja e rreme për fetarinë e pastër.

*"A ka ndonjë keqbërës më të madh se ai që shpif gënjeshtër ndaj Allahut për t'i shpënë njerëzit në humbje nga padija"?*

(Kuran, 6/144)

*"Thuaju: sigurisht, atyre që shpifin gënjeshtër për Allahun, nuk do t'u ecë mbarë".*

(Kuran 10/69)

*"Do të dëshmojnë dëshmitarët për ata se janë prezantuar në mënyrë të rreme në emër të Zotit. Le t'i arrijë ndëshkimi hyjnor. Edhe një herë: a ka keqbërës më të madh se ai që shpif ndaj Allahut duke thënë: Kjo më është shpallur mua", por Zoti asgjë nuk i ka shpallur.*

(Kuran, 6/93)

*"Në Ditën e Kiametit do t'i shihni ata që kanë trilluar gënjeshtër për Allahun, me fytyra të nxira. Vallë a nuk është Xhehenemi për mendjemëdhenjtë"?*

(Kuran, (39/60)

Nuk është çudi që Kurani i madhëruar është i ashpër për gjykimin e gënjeshtarëve ndaj Zotit, sepse që nga themelimi, ekzistenca, vazhdimisht ka qenë më lehtë të mbrohet feja nga femohimi, sesa fetaria e kulluar nga papastërtia. Profetët e rremë të fesë e përlyejnë shumë më tepër fenë sesa mohuesit e sinqertë të saj. Këta të fundit, në të vërtetë, e pastrojnë fenë nga përlyerja e profetëve të gënjeshtërt. Është e vështirë të pranohet, por kritika e fetarisë së kulluar është metodë e domosdoshme për pastrimin ndërgjegjes fetare, sidomos atëherë kur substanca potenciale e saj tjetërsohet në formën e vërtetë të teologjisë instruktive, ose në përcaktimin e funksionit religjioz. Kriza e tanishme morale në botë është mjaft e madhe, mbase më e madhja, dhe rezultati triumfal i rikthimit të religjionit ose i teologjisë në skenën e botës ashtu siç ka qenë, më tepër se një shekull, është hedhur në një cep të pamundësisë së vet që t'u përgjigjet kërkesave të kohës. Kjo tingëllon në mënyrë paradoksale. A nuk është rikthimi i religjionit nga "burgu" njëkohësisht rikthimi i religjionit "në lirinë" morale? Për fat të keq, jo.

Mendimi bashkëkohor religjioz ose teologjik, jo vetëm moralisht është atrofizuar, por është bërë edhe i paqëndrueshëm, për arsye se në mendimin moral, ai humbet qëllimin e ekzistencës së vet. Mendimi i sotëm religjioz, nuk është në dialog me polin e vet antireligjioz, i cili e ndihmon që të shihet në pasqyrën e tij. Në të vërtetë, religjioni sot nuk është në dialog me askënd. Ai sot, për sa i përket qëndrimit moral, është në përleshje me të gjithë, duke përjashtuar ata që duhet ta mbështesin ose ta mbajnë në nivel të lartë. Përse janë tërhequr kritikët e mendimit religjioz? Ata janë më të domosdoshëm se asnjëherë tjetër që ta pastrojnë fetarinë nga mendimi i papastër religjioz, i cili bën kompromise për llogari të ndërgjegjes morale. Religjioni sot është në krizë, jo sepse mungon, por sepse ekziston në mënyrë dhe në vend të gabuar. Ashtu si deri më sot, pastrimi i mendimit religjioz ose i mendimit teologjik, nuk është i mundur nga jashtë, por nga brenda, me kushtin që ata që janë brenda rrethit religjioz ose teologjik, të njohin rrezikshmërinë e jashtme. Sot ata që janë brenda nuk kanë frikë, kurse ata që janë jashtë, nuk janë të qëndrueshëm. Fetaria e kulluar do të rifillojë të flasë, sepse shpirti njerëzor, nuk mund të durojë gjatë mashtrimin e djallit. Kushti i parë për shërim të saktë, është që të pranohet

se ekziston sëmundja. Për këtë arsye mendimi religjioz ose teologjik janë në krizë, sepse botën e sundon kriza morale, e cila shfaqet si pasojë e konsumimit të fetarisë së kulluar për kërkesat e ndërjegjes së papastër.

### **A është njeriu kafshë që flet?**

Në ndryshim nga kafsha që është krijesë me instinkte, njeriu është krijesë me diktat. I vogli i drerit sapo lind, qëndron në këmbë, e sipas instinktit ushqehet me qumështin e nënës. E ëma, po kështu, sipas instinktit, i jep qumësht të voglit. Pas ushqimit të parë, i vogli i drerit, është i gatshëm të vrapojë krahas nënës. I vogli i njeriut është i pafuqishëm. Ai do të vdiste nëse nëna nuk do ta përqafonte dhe t'i jepte gji. Diktati i dashurisë së nënës është vendimtar për jetën e vogëlushit. Por, edhe diktati i dashurisë së vogëlushit për jetën është vendimtar për të mbijetuar. Definicioni i vjetër "Njeriu është kafshë...që flet" vlen për filozofinë, por në fe ky definicion nuk ka rëndësi. Në fe thuhet: "Njeriu nuk është kafshë". Në fe njeriu është i frymëzuar nga Zoti me shpirt që ka aftësi të vetënjohjes, si p.sh. njohjen e Krijuesit të vet. A nuk është kërkesë e çuditshme që njeriu të radhitet me kafshën, e cila nuk mund të bashkërenditet me njeriun, pikërisht për vetë faktin se kafsha ka instinktin që njeriu nuk e ka dhe kafsha nuk ka aftësi vetënjohjeje, të cilat njeriu i ka?! Gjithsesi, kjo kërkesë mbetet e çuditshme pikërisht për faktin se njeriu në vetvete është i çuditshëm, sepse vazhdimisht largohet nga vetvetja. Që nga krijimi njeriu dëshiron të jetë ai që është, për arsye se nuk dëshiron të jetë ai që nuk është. Por, njeriu, në të vërtetë, nuk di çfarë do, as nuk di ç'është ajo që ai do. Njeriu është i krijuar sipas diktatit, i pëlqen kjo atij apo jo. Askush nuk e pyet për asgjë, veçse ai vetveten: "Përse jam krijuar mbi tokë"? Djalli e ka nxitur që të thotë se djalli është më i mirë se ai, ngaqë është krijuar prej zjarrit. Ky ka qenë vetëm një shkak që njeriu të revoltohet kundër Zotit. Kjo revoltë e ndjek që nga krijimi e deri më sot. Madje edhe kur i thuhet qartë se është krijesa më e bukur mbi tokë, njeriu përsëri nuk është as i lumtur, as i kënaqur. Nuk është i kënaqur që ta përcaktojë atë që e ka krijuar, madje sikur kjo të ishte njohja më e madhe. Njeriu, kërkon që të përcaktojë vetveten e të thotë: "Unë jam kafshë...që flet". Këtu ai e ndien veten të bashkëradhitur me

kafshët, të cilat nuk janë aspak fajtore që njeriu radhitet me to. Kafshët janë plotësisht të pafajshme. Kafshët nuk janë fajtore se njeriu i kriminalizon duke i radhitur me veten, sidomos atëherë kur bie në fund. (arabisht: *esfele-safilin*).

### **Rruga e dritës dhe rruga e zjarrit**

Njeriu është tokë, dhe (arabisht: *turab*); engjëlli është dritë (arabisht: *nur*); djalli është zjarr (arabisht: *nar*). Dheu ka edhe dritën, edhe zjarrin; në tokë drita ndizet, kurse zjarri digjet. Njeriu përbëhet nga toka, me elemente të mbitokës edhe të nëntokës; njeriu është sintezë e dritës engjëjllore (*nur*) që ndizet dhe zjarrit (*nar*) të djallit që digjet. Drita engjëjllore (*nuri*) është mendja e njeriut, zjarri i djallit është ndjenja (epshi) e tij. Njeriu është dhe, tokë, nga ku ndizet drita dhe ku digjet zjarri; engjëjt te njeriu ndezin mendjen e tij me dritën e tyre, kurse djalli ndez tek ai ndjenjën me zjarrin e tij; njeriu është dhe ndërmjet dritës së engjëllit dhe zjarrit të djallit. Në dukje kjo është lojë fjalësh, por në të vërtetë, drita dhe zjarri janë dy rrugë të njeriut – rruga e dritës dhe rruga e zjarrit. Në udhën e dritës njeriu sheh gjithçka rreth vetes, pas dhe para vetes; në rrugën e zjarrit njeriu sheh vetëm para vetes e pas vetes errësirë dhe hi. Zjarri është më i fuqishëm dhe më shkatërrues se drita; zjarri është shqetësues dhe i frikshëm. Drita është e ndjeshme, e butë, parashikuese dhe ndonjëherë e mërzitshme, por asnjëherë dashakeqë, ajo nuk e lë njeriun asnjëherë në errësirë, as nuk e mbulon me hi.

### **Pa ekzistencën e diktatit nuk ka mendje**

Asnjëherë nuk do ta kem të qartë keqardhjen e njeriut që nuk është krijuar nga zjarri. Kjo sepse po të mos i vinte keq, nuk do ta provokonte djalli me retorikën e vet raciste. Gjithashtu, asnjëherë nuk do ta kem të qartë se për ç'arsye njeriu dëshiron të imitojë djallin, i cili e urren njeriun më tepër se çdo gjë, për shkak se Zoti i ka diktuar që t'i përulet atij, sepse njeriu ka mundësi njohjeje që djalli nuk i ka.

Në të vërtetë, pyes pse njeriu dëgjon diktatin e djallit, i cili e shtyn në zjarr dhe e shmang që të dëgjojë diktatin e Krijuesit që e udhëzon te drita? Kjo është ajo e vërtetë që dua të kuptohet,

e kjo është se njeriu nuk mund të zgjedhë veçse të pranojë diktatin. Në të vërtetë, diktati është fati i tij. Nuk është kjo as karakter i qëndrueshëm, as dëshirë e qëndrueshme, por ato janë edhe karakteri, edhe dëshira e tij. Gjithashtu, diktati është ai që përcakton ekzistencën e tij. Ekzistenca e tij është forca, potenciali i njohjes që nuk janë të trashëgueshme, por çdo njeri fillon të lexojë, të mësojë dhe të njohë vetveten, edhe sipas diktatit qëi ofrohet.

Njeriu ka liri zgjedhjeje për një ose më shumë diktate, por nuk ka zgjedhje për të jetuar pa një diktat në përgjithësi. Diktati i besimit është njëri nga zgjedhjet e tij të lira. Gjithsesi, ekziston edhe diktati i femohimit. Njeriu është i lirë të zgjedhë njërin nga këto dy diktate. Pa ekzistencën e diktatit nuk ka mendje. Agnostikët që krenohen se janë neutralë, ose të paimterësuar për të njohur fenë e besimit të Zotit, mashtrojnë vetveten para se të na mashtrojnë ne, që e dimë se çfarë është agnosisi i tyre, të cilin, ashtu si dhe gnosisi, ata duhet t'ia shpjegojnë më së pari vetvetes se sa ndonjë tjetri. Por çdo shpjegim është rezultat i njohjes ose i njohjes së asaj që shpjegohet, e kjo është agnosis agnostika, që në të vërtetë është gnosisi i vet.

### **Zotimi i lashtë nuk fshihet nga shpirti i njeriut**

Zotimi i njeriut, që e transmeton Kurani<sup>(2)</sup>, për njohjen e Krijuesit si Zotin e vet, akoma edhe tani jehon në kozmos. Ky është një diktat i vërtetë i fetarisë, që ata, duke shkruar zotimin ndaj Zotit në shpirt, e kanë shkruar besimin ndaj Zotit në zemrën e tyre. Ata kanë lënë gjurmë të vetvetja të vërtetën e pastër, si fe të kulluar, si premtim të kulluar, si ide të kulluar për vetveten në marrëdhënie me Zotin, por edhe idenë për veten lidhur me vetveten. Njerëzit që e kanë ruajtur këtë zotim që nga krijimi i tyre janë ata të cilëve u dridhet zemra kur përmendet emri i Zotit dhe të cilëve u forcohet besimi, kur u lexohen ajetet kuranore. Ky premtim i hershëm i dhënë Zotit, si një "ID", nuk mund të priset apo të zhduket nga shpirti i çdo njeriu. Ky premtim ose "ID" mund të interpretohet ndryshe nga ç'është në realitet, mund të harrohet, mund të lihet në hije ose të mohohet, por asnjëherë nuk mund të zhduket. Ata që e mohojnë, nuk e pakësojnë kuptimin

---

<sup>2</sup> Shih: Kuran, 7: 172.

dhe rëndësinë e tij për ata që e njohin dhe e pranojnë. Ata që e fshijnë nuk kanë aq furça sa të zhdukin fjalët që te Krijuesi janë aq sa *“sikur të gjithë detet të ishin bojë, e gjithë drunjtë mbi tokë pena, më parë do të thaheshin detet dhe do të mbaronin drunjtë, sesa do të mbaroheshin fjalët e Krijuesit, nga të cilat edhe fjalët e këtij zotimi, janë fjalët e Zotit, si premtim i përjetshëm i njeriut dhënë Zotit”*.

### **Pas Frojdit fetaria e kulluar nuk është më e tillë**

Sigmund Frojdi nuk është as i pari as i fundit që është përpjekur të fshijë këtë “ID” nga ndërgjegjja e njeriut dhe t’i vendosë njeriut konceptin e vet kaotik të “ID”-së, i cili përbëhet nga i pastri “libido”, instinkti seksual, si burim kryesor i forcës instinktive njerëzore, që është në përleshje me botën reale. Libido, “ID” - ja e Frojdit, vepron sipas parimit të kënaqësisë së kulluar, sipas definicionit është i pavetëdijshëm dhe sipas qëllimit është ateist dhe aspak premtues. Përpjekja e Frojdit për të fshirë “ID”-në hyjnore (zotimin e dhënë Krijuesit) dhe për të regjistruar “ID”-në e vet (libido) është e njëjtë me provën e Ademit për të shijuar mollën e ndaluar. Ademi, kësisoj, ka qenë i pari që ka kafshuar fetarinë e kulluar dhe ka shkelur premtimin në parajsë; Frojdi nuk është i pari, por është më nxitësi duke mbrojtur idenë se njeriu mund të jetojë sikur të mos kishte Zot, që ka shkelur fetarinë e kulluar ndaj Zotit mbi tokë. Pas Frojdit fetaria e kulluar nuk është më e tillë, as premtimi i njeriut dhënë Zotit, ashtu edhe premtimi i Zotit dhënë njeriut, i pranishëm në ndërgjegjen e njeriut.

Njeriu bazohet në tri dimensione të gjendjes së vet psikologjike ose shpirtërore: “ID”, “ego”, “superego”. Këtu nuk ka asgjë hyjnore. Të gjitha duhet të ishin vetëm njerëzore, por përsëri nuk janë të tilla, sepse “ID”-ja e Frojdit nuk ka vetëdije për asgjë, po kështu as për vetveten si gjendje e dytë e tij “ego”. Frojdi nuk e di me saktësi se si njeriu ndërgjegjësohet me vetveten nëse është gjykuar në fillim që “ID”-ja e tij e parë është kaotike dhe e pavetëdijshme. Askush nuk e di, as Frojdi, se çfarë i ndodh njeriut nga gjendja e tij e pavetëdijshme “ID”, deri te gjendja e tij e vetëdijshme (“ego”) dhe te gjendja e tij mbinjerëzore (“superego”), kur njeriu në vend të Zotit, e sheh dhe e kontrollon veten, e vlerëson dhe e shpërblen, e madhon dhe e lavdëron, dhe vetvetja bëhet qëllim dhe synim...

## **Ç'është më e keqe, gjysmë e vërteta apo gjysmëgënjeshtër?**

“Fetaria e kulluar” si diktat i besimit ndaj Zotit nga “zotimi i përjetshëm” është më e vështirë të ruhet e pastër nga gjysmë e vërteta dhe gjysmëgënjeshtër. Gënjeshtër e pastër është e qartë dhe njeriu mund të ruhet nga ajo; e vërteta e pastër është e pastër dhe njeriu mund të pajtohet lehtë me të. Por gjysmë e vërteta dhe gjysmëgënjeshtër janë jo të qarta dhe jo të pastra e për këtë arsye njeriu e ka të vështirë të ruhet dhe të mbrohet nga ato. Për këtë arsye na duhet “kritika e fetarisë së kulluar”, nëpërmjet së cilës duhet të mësojmë se si të mbrohemi nga gjysmë e vërteta dhe gjysmëgënjeshtër, shfaqje që sot rëndojnë mbi bashkësinë tonë. Ndaj këtyre shfaqjeve dijetarët duhet të tregojnë më tepër kujdes, jo vetëm që të mos ekzistojnë gjysmë e vërteta dhe gjysmëgënjeshtër, por që dijetarët me ose pa ndërgjegje të mos i lejojnë ato duke shfrytëzuar mundësitë personale. Dijetarët myslimanë nuk kanë qenë asnjëherë para një sprove më të madhe se kjo e sotmja, duke ngecur te gjysmë e vërteta dhe gjysmëgënjeshtër. Nuk dihet cila është më e keqe, gjysmë e vërteta apo gjysmëgënjeshtër, por gjysmë e vërteta është më helmuese dhe më e rrezikshme. Nuk thuhet pa shkak në Kuranin famëlartë se *“gjysmë e vërteta dhe gjysmëgënjeshtër janë më të këqija se vrasja”*. Edhe Dante Aligieri që ka studuar në Andaluzinë myslimane e ka vendosur tradhëtarin menjëherë te djalli në rrethin e nëntë të ferrit, ndërsa vrasësin, kriminelin, e ka lënë në rrethin e tetë. Gjatë gjithë kohës duhet ruajtur “fetaria e kulluar” nga gjysmë e vërteta dhe gjysmëgënjeshtër si “faqe e pastër”.